



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor
dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
ee.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 202500513/4

Tiranë ____/____/2025

Lënda : *Rekomandim për përshpejtimin e përfundimit të procedurës administrative të filluar mbi bazë të vetëdeklarimit datë 08.11.2006, për legalizim ndërtimi informal, nga shtetasi A. Ll. .*

Drejtuar : **Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

SARANDË

Për dijeni: **Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**
Adresa: Rruga "Dora D'Istria"

TIRANË

Të nderuar!

Sikurse jeni në dijeni, Institucioni i Avokatit të Popullit (në vijim AP), në ushtrim të kompetencave kushtetuese e ligjore për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve shqiptarë dhe të huaj që jetojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë, ka marrë në administrim ankesën e shtetasit A. Ll. , në të cilën prezantohet çështja e shkeljes/cënimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mospërfundimit të veprimtarisë administrative në shqyrtimin e vetëdeklarimit, datë 08.11.2006, të kryer nga ana e tij për legalizimin e ndërtimit informal, banesë një katëshe e ndodhur në Fshatin Berdenesh, Bashkia, Sarandë. Në ankesën drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, ankuesi shprehet, se:

"... jam emigrant në Greqi, që në ato vite dhe sa herë që vij në shtëpi me pushime, jam interesuar tek ky institucion (kupto DVASHK, Sarandë) për t'u pajisur me leje legalizimi, pasi

komshinjtë e mi janë të pajisur me leje legalizimi. Përveç se na kanë thënë që duhet të presim nuk është bërë asnjë lëvizje nga ana e tyre. Po kërkoj të bëj rrethim të ambientit përreth shtëpisë dhe nuk po pajisem dot me leje rrethimi vetëm për mungesë të lejes së legalizimit. Po kalojnë rreth 20 vjet dhe nuk kam asnjë njoftim për të ndërmarrë veprime të tjera për legalizim ...”.

Me rastin e pranimit për shqyrtim të çështjes së prezantuar prej shtetasit A. Ll. , Institucioni ynë, me shkresën nr. K3/A1-2 Prot., datë 30.01.2024 ka kërkuar Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK), Sarandë, informacion dhe shpjegime, lidhur me:

- Shkaqet që kanë justifikuar dhe justifikojnë mospërfundimin e shqyrtimit të vetëdeklarimit, viti 2006, të kryer prej ankuesit;
- Nëse në zonën kadastrale ku ndodhet ndërtimi informal i ankuesit, a janë legalizuar më parë ndërtime informale të kryer prej subjekteve të ndryshëm? Nëse po, si shpjegohet mospërfundimi i shqyrtimit dhe të vetëdeklarimit të ankuesit?
- Prezantimin e mundësive për përfundimin sa më parë të procedimit administrativ lidhur me vetëdeklarimin, viti 2006, të ankuesit;
- Çdo informacion tjetër që ka lidhje me këtë çështje.

Në përgjigje të informacionit dhe shpjegimeve të kërkuara, me shkresën nr. 1368/1 prot, datë 09.02.2024, drejtuar AP-së, ju shpreheni, midis të tjerave, se:

“... Nga verifikimet e kryera pranë arkivës së Sektorit të Legalizimeve, Çështjeve të Pronësisë dhe Proçeseve Hartografike, rezulton vetëdeklarimi datë 08.11.2006, me subjekt aplikues A. Ll. , dosje e cila gjendet ende në fazë fillestare, e pa marrë në shqyrtim nga ana e institucionit tonë, si pasojë e mosinteresimit të subjektit aplikues dhe mospasja e numrit të kontaktit në dosje.

Me anë të shkresës datë 09.01.2024, administruar nga ASHK, Sarandë, me nr.362 prot, datë 10.01.2024, shtetasi A. Ll. ka nisur kërkesë për vazhdimin e procedurave administrative të praktikës së tij të legalizimit.

Sa më sipër, DVASHK, Sarandë, do ta ketë prioritet në planin e punës shqyrtimin e kësaj praktike dhe në momentin që do konkludojë në një vendimmarrje në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe në vijimësi, do të ju informojë mbi ecurinë e saj.

Bashkangjitur kopje e kërkesës datë 09.01.2024, administruar nga ASHK, Sarandë, me nr. 362 prot, datë 10.01.2024, e shtetasit A. Ll.”.

Referuar akteve të vëna në dispozicion prej ankuesit, deklarimeve të tij, informacionit të dhënë prej DVASHK, Sarandë, konstatohet se, ish-ALUIZNI, Sarandë, sot DVASHK, Sarandë, në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimit datë 08.11.2006, të ankuesit, për legalizimin e ndërtimit (banesës një katëshe) informale të ndodhur në Fshatin Berdenesh, Bashkia, Sarandë, nuk ka kryer ende procedura për shqyrtim.

Në situatën që ndodhet çështja e shqyrtimit të vetëdeklarimit të kryer prej ankuesit, konstatojmë se:

Së pari. Ka kaluar një kohë tejet e gjatë që nga momenti i depozitimit të aplikimit/vetëdeklarimit për legalizimin e ndërtimit informal datë 08.11.2006, të paraqitur nga ana e z. A. Ll. , në organin përkatës kompetent sipas legjislacionit në fuqi të kohës. Pra, janë

afërsisht 19 vite, përgjatë të cilave nuk ka filluar dhe përfunduar së shqyrtuari vetëdeklarimi datë 08.11.2006, i ankuesit.

Së dyti. Nuk prezantohet asnjë shkak prej DVASHK, Sarandë, i cili do mund të justifikonte kohëzgjatjen faktike të procedurës administrative, për shqyrtimin e vetëdeklarimit datë 08.11.2006, të ankuesit. Justifikimi i mosinteresimit të aplikuesit/ankuesit në procesin e shqyrtimit nga ana juaj të vetëdeklarimit datë 08.11.2006, shprehur nga ana juaj në shkresën nr. 1368/1 prot, datë 09.02.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, jo vetëm nuk gjen mbështetje në ligj, por është tregues i neglizhencës së skajshme në përmbushjen rregullisht të detyrimeve të parashikuara në ligj për përfundimin e procesit administrativ të shqyrtimit të vetëdeklarimit në fjalë. Ky pretendim **nuk mund të justifikojë** pasivitetin e DVASHK, Sarandë, si organ publik për kaq shumë kohë, dhe për arsye të mëposhtme:

a) Parimi i administrimit proaktiv dhe shërbimit ndaj qytetarit

Organi publik, DVASHK, Sarandë, ka për detyrë **të veprojë me iniciativë**, bazuar në dokumentacionin dhe kërkesat që i janë paraqitur. Mosinteresimi i përkohshëm apo heshtja e qytetarit **nuk e shfuqizon apo pezullon vetvetiu procesin**;

b) Mungesa e komunikimit nga ana e institucionit

Në kushtet kur DVASHK, Sarandë, nuk ka komunikuar zyrtarisht me vetëdeklaruesin, z. A. Ll. , për kërkesa shtesë, për mospërputhje dokumentacioni, apo për veprime që duhej të kryente qytetari, atëherë **faji mbetet mbi institucionin**. Madje, sipas Kodit të Procedurave Administrative (Ligji 44/2015), institucioni duhet të njoftojë palën për çdo hap dhe të përcaktojë afate për përgjigje;

Afatet procedurale dhe papajtueshmëria me pritshmëritë e drejtësisë

Afro 19 vite pritje janë në tejkallim ekstrem të çdo afati të arsyeshëm. **E drejta për një administrim efikas dhe të drejtë** është e garantuar nga ligji dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese dhe asaj Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

DVASHK, Sarandë, si organ përgjegjës për përfundimin e procedurës, ka **detyrimin ligjor dhe institucional** për të ndjekur dhe përfunduar procedurën administrative të legalizimit pas paraqitjes së vetëdeklarimit nga qytetari. Në momentin që qytetari ka depozituar vetëdeklarimin, **ngarkohet organi publik me detyrimin për të vijuar procedurat**: verifikimin në terren, miratimin e hartës së pronës, nxjerrjen e vendimit për legalizim, e më tej përgatitjen/lëshimin e dokumentacionit të pronësisë. Zvarritja për një periudhë kaq të gjatë (nga viti 2006) është **një dështim i pajustificueshëm i DVASHK, Sarandë**, në përmbushjen e funksioneve të saj, që përbënë edhe shkelje të të drejtave të qytetarit sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ (e drejta për një proces të rregullt dhe në kohë të arsyeshme).

Pretendimi i organit publik se procedura nuk ka përfunduar për shkak të "mosinteresimit" të qytetarit nuk qëndron nga pikëpamja ligjore dhe administrative, për sa kohë:

- Procedura është iniciuar nga qytetari (me vetëdeklarimin);
- Organi publik nuk ka dokumentuar, njoftuar apo ndërmarrë hapa për të zgjidhur çështjen;

- Nuk është bërë përpjekje e dokumentuar për të kërkuar bashkëpunim apo për të përfunduar procedurën;

Kalimi i një periudhe shumë të gjatë (që nga 2006) pa vendimmarrje është i pajustificueshëm dhe përbën **shkelje të të drejtës për një administrim në kohë të arsyeshme**.

Së treti. DVASHK-ja Sarandë, pa shkak të ligjshëm nuk vijon procedurën e shqyrtimit të vetëdeklarimit datë 08.11.2006, edhe pse ankuesi është i gatshëm të përmbush detyrimet e tij si palë me interes të drejtëpërdrejtë në procedurën administrative që po zhvillohet në këtë rast, ndërkohë që, DVASHK-ja Sarandë, nuk është në të njëjtat pozita.

Së katërti. Vërehet një mungesë e vazhduar e dhënies së informacionit kërkuar z. A. Ll. , për ecurinë e procesit administrativ, nominal të legalizimit, fakt që evidenton një tjetër shkak të drejtëpërdrejtë për cënimin e së drejtës themelore të njeriut, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe të cënimit të interesave pasurore të tij, si subjekt posedues i pasurisë së paluajtshme në këtë proces.

Baza specifike ligjore mbi të cilën ushtron veprimtarinë Agjencia Shtetërore e Kadastrës, është ligji nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, ku parashikohen edhe parimet nga të cilat udhëhiqen proceset kalimtare të kalimit të pronësisë, pjesë e të cilave është edhe procesi i legalizimit të ndërtimeve pa leje.

Nisur nga rrethanat e parashtruara në këtë çështje si dhe nga informacioni i paraqitur nga ana juaj si drejtori vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, evidentohet qartë fillimi i një procedure administrative të bazuar në rregullimet e një legjislacioni specifik, mbi legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje,¹ e cila sot pas më shumë se 19 vitesh nuk ka përfunduar ende me një akt administrativ (*vendim përfundimtar*), të nxjerrë nga organi përkatës, përgjegjës, publik, në të cilin vendoset legalizimi ose jo i objektit përkatës, të ngritur pa leje ndërtimi.

Vetëdeklarimi për legalizim është kryer nga z. A. Ll. , me aplikimin datë 08.11.2006, për objektin informal të ndodhur në Fshatin Berdenesh, Sarandë. Në varësi të përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, të kohës, për trajtimin e këtij vetëdeklarimi dhe nga analiza e të gjithë afateve ligjore procedurale të vendosura nga ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, (tashmë i shfuqizuar nga ligji nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*), nuk përcaktohet një afat konkret, kohor, brenda të cilit duhet të përfundonte procedimi administrativ, me nxjerrjen e një vendimi për legalizimin ose jo të një ndërtimi informal, apo të një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi.

Kjo problematikë është bërë prezente hershëm, në rekomandimet e Avokatit të Popullit, drejtuar organeve të administratës publike, përgjegjëse për mbarrëvajtjen e procesit të legalizimit të iniciuar mbi bazën e vetëdeklarimeve të paraqitura nga subjektet e interesuara.

Sjellim në vëmendje gjithashtu, faktin se, në informacionin dhe shpjegimet e dërguara nga DVASHK, Sarandë, nuk ka asnjë shpjegim, apo informacion se, për çfarë arsye nuk janë kryer

¹ Në varësi të kohës së vetëdeklarimit për përfshirje në procesin e legalizimit, duhet të mbahet parasysh si bazë ligjore, ligji nr. 9482 datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar, si dhe ligji nr.20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*.

procedura për shqyrtimin e vetëdeklarimit nr. 1584, datë 08.11.2006, të ankuesit. Deklarimi i kryer në shkresën nr. 1368/1 prot, datë 09.02.2024, se vetëdeklarimit datë 08.11.2006, nuk është shqyrtuar: “... si pasojë e mosinteresimit të subjektit aplikues dhe mospasja e numrit të kontaktit në dosje”, nuk gjen mbështetje në ligj, për rrjedhojë, ky qëndrim, nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë të parashikuar në nenin 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”. Nisja e procedurës së shqyrtimit të vetëdeklarimit për legalizimin e një ndërtimi informal nuk kushtëzohet nga legjislacioni në fuqi me disponimin më parë nga drejtoria vendore e ASHK-së të adresës së kërkuarit/aplikuesit, apo shprehjen e interesit vijues nga ana e tij për shqyrtimin vetëdeklarimit të kryer.

Në funksion të parashikimit të nenit 17, pika 6, dhe nenit 69, pika 9, të ligjit nr. 20/2020, është nxjerrë VKM-ja nr. 1178, datë 24.12.2020 “Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”, në të cilën, përcaktohet dokumentacioni dhe rregullat e hollësishme për evidentimin e ndërtimeve pa leje, proces i cili përbëhet nga dy etapa:

- a) evidentimi në terren i gjendjes ndërtimore;
- b) evidentimi i faktit nëse ndërtimi përfshihet në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, në përputhje me nenin 17, pika 1, dhe nenin 69, pika 9, të tij.

Kryerja e procedurave të parashikuara në aktin e lartpërmendur ligjor, në procesin e shqyrtimit të vetëdeklarimit të ankuesit, nuk kushtëzohet me disponimin më parë të adresës së kërkuarit, apo shprehjen e interesit vijues nga ana e tij për shqyrtimin vetëdeklarimit të kryer. Nëse DVASHK, Sarandë, do të kryej procedurat sikurse përcaktuar në VKM-në nr. 1178/2020, vendndodhja e ndërtimit informal të ankuesit (adresa e banesës së tij) është lehtësisht e gjatshme në Fshatin Berdenesh, Sarandë, nisur nga dokumentacioni hartografik i vënë në dispozicion prej ankuesit me rastin e dorëzimit të vetëdeklarimit datë 08.11.2006, apo bashkëpunimit me organin vendor në territorin e të cilit ndodhet ky ndërtim informal.

Referuar faktit që bashkëlidhur Tuajës nr. 1368/1 prot, datë 09.02.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, keni dërguar kopje të kërkesës së ankuesit, datë 09.01.2024, drejtuar DVASHK-së, Sarandë, për vijimin e procedurave në shqyrtimin e vetëdeklarimit, kuptohet se, keni të administruar dhe adresën e dërguesit (ankuesit). Në këtë kërkesë të ankuesit, administruar prej DVASHK, Sarandë, me nr. 362, datë 10.01.2024, gjenden dhe tre numra telefonik me anë të të cilëve mundësohet komunikimi kërkuar me ankuesin.

Në referencë të dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative,² koncepti i procedimit/procedurës administrative, që në këtë problematikë lidhet me aplikimet rast pas rasti për legalizim të një ndërtimi informal, apo të një shtese informale në një objekt me leje ndërtimi, është një proces që inicohet nga një subjekt që ka interes të drejtëpërdrejtë në këtë çështje, vazhdon me zhvillimin e procedurave administrative (brenda afateve ligjore dhe gjatë të cilave mund të nxirren edhe vendime të ndërmjetme administrative), dhe përfundon me nxjerrjen e aktit administrativ përkatës prej organit publik përgjegjës.

Në varësi të kohës së kryerjes së aplikimit nga z. A. Ll. , dhe legjislacionit specifik në fuqi, të kohës, për trajtimin e këtij aplikimi, si dhe në mungesë të një afati kohor taksativ të dhënë në këtë legjislacion specifik, për përfundimin e procedimit/procedurës administrative për këtë rast,

² Në këtë përcaktim është mbajtur parasysh përmbajtja e dispozitave të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (i cili ka shfuqizuar ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999).

konstatohet se nuk jemi në një rast vakumi ligjor të përcaktimit të këtij afati (dhe aq më pak në kuptim të konceptit të përfundimit të procedurës brenda një afati të arsyeshëm), pasi në nenin 49/1, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, përcaktohet se:

“Procedimi administrativ përfundon brenda një periudhe kohore prej 3 muajsh, me përjashtim të rastit kur parashikohet ndryshe në ligje të veçanta, ose kur imponohet nga situata të veçanta. Në rastin e situatave të veçanta, procedimi administrativ përfundon 3 muaj pas ndërprerjes së situatës, së veçantë”.

Ky afat 3 muaj për përfundimin e procedimit administrativ ka ndryshuar me rastin e hyrjes në fuqi të kodit të ri të procedurës administrative, ligjit nr. 44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, i cili në nenin 91/2 parashikon afatin 60 ditë për përfundimin të këtij procesi, në mungesë të afateve të përcaktuara në ligjin e posaçëm.

Procesi i legalizimit i parashikuar dhe rregulluar me ligj është një proces që bazohet në vullnetin e lirë të subjekteve të cilët, megjithëse efektivisht kanë kryer një shkelje ligjore, kanë të drejtën dhe mundësinë që të “korrigjojnë” atë përmes kërimit të fillimit dhe zhvillimit të një procesi administrativ, i cili mbart detyrime dhe të drejta për ata vetë në radhë të parë, por dhe për organet përgjegjëse të administratës publike të përfshira në proces.

Nuk duhet harruar nga ana tjetër se, ky proces tashmë i emërtuar kalimtar³ nga legjislacioni në fuqi, është i lidhur me një sërë procesesh të tjera shumë të rëndësishme, sikurse ai i kthimit dhe kompensimit të pronës ish pronarëve, regjistrimit të pasurive të paluajtëshme, zhvillimit urban të zonave të banuara, etj.

Në këto kushte çdo vonesë në procesin e legalizimit, urbanizimit dhe integritetit të ndërtimeve pa leje, jo vetëm lidhet me respektimin e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të subjekteve që kanë aplikuar për t’u përfshirë në të por paraqitet edhe si një vonesë, apo pengesë edhe për gjithë zinxhirin e proceseve të tjera administrative-ligjore, të lidhura me të.

Mosrespektimi rast pas rasti i këtij afati ligjor të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, i kohës, ka krijuar probleme në vet punën e organeve të administratës publike të përfshira në procesin e legalizimit, ka krijuar probleme tek subjektet vetëdeklaruese/aplikuese, dhe rrjedhimisht ka krijuar probleme në shumë procese të tjera ligjore që ndërthuren përgjatë zhvillimit të tyre, me procesin e legalizimeve.

Situata e krijuar evidenton edhe problematikën tërësisht të pajustificuar të kohëzgjatjes së një procedure administrative prej mëse 19 vitesh (ende të papërfunduar), si në rastin e vetëdeklaruesit/aplikuesit A. Ll. , ku megjithëse ky i fundit ka aplikuar për legalizim të ndërtimit pa leje që në vitin 2006, ende nuk ka një vendim përfundimtar për këtë procedurë.

Po ashtu, Institucioni ynë administron dokumentacionin teknik, plan vendosje e ndërtesës objekt legalizimi, për gatitur prej ekspertit të licencuar ing. E. L. , edhe pse për gatitja e këtij dokumenti sipas përcaktimeve të VKM-së nr. 1178, datë 24.12.2020, *“Për përcaktimin e dokumentacionit dhe të rregullave të hollësishme të evidentimit të ndërtimeve pa leje”*, është detyrim i DVASHK, Sarandë. Në shkresën nr. 1368/1 prot, datë 09.02.2024, drejtuar Avokatit të Popullit, DVASHK, Sarandë, shprehet për trajtimin/shqyrtimin me prioritet të vetëdeklarimit

³ Ligji nr.20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*.

datë 08.11.2006, të ankuesit. Edhe pse, kanë kaluar më shumë se 16 muaj nga dita e konfirmimit tuaj për trajtimin me prioritet të vetëdeklarimit të ankuesit, konstatohet se, shqyrtimi i tij ende nuk ka përfunduar së shqyrtuari. Në komunikimin elektronik së fundmi me ankuesin, deklarohet se, DVASHK, Sarandë, nuk ka kryer asnjë procedurë për shqyrtimin e vetëdeklarimit të tij, ndërkohë që për disa ndërtime të tjera informale të ndodhura në këtë fshat, procesi i legalizimit ka përfunduar.

Blloku kadastral si një **njësi territoriale e ndarë në mënyrë të saktë gjeografike**, përmban një numër pasurish të paluajtshme (si toka, ndërtesa, parcela) të cilat regjistrohen dhe administrohen në kadastrë.

Çdo bllok kadastral:

- Identifikohet me **një numër unik** (p.sh. 8510);
- Ka **kufi të përcaktuara qartë** në hartën kadastrale;
- Mund të përfaqësojë një zonë urbane ose rurale të caktuar brenda një njësie administrative (si p.sh. një lagje, fshat ose pjesë të një qyteti).

Funksioni i bllokut kadastral:

1. ✓ **Organizim i informacionit kadastral:** Lehtëson regjistrimin, përditësimin dhe kontrollin e të dhënave për pronësinë dhe përdorimin e tokës.
2. ✓ **Referencë unike për pasuritë:** Çdo pasuri brenda një blloku identifikohet me një **numër pasurie**, i cili në kombinim me numrin e bllokut, krijon identifikuesin e saktë (p.sh. pasuria nr. 31/3, në bllokun kadastral 8510).
3. ✓ **Përdorim në proceset ligjore dhe administrative:** Nevojitet për transaksione pronësie, legalizime, rivlerësime, kompensime, etj.

Mosveprimi dhe zvarritja tërësisht e pajustificuar ligjorisht, e konstatuar në këtë çështje, nxjerr në konkluzionin se kemi të bëjmë me cënim të së drejtës themelore të z. A. Ll. , për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në nenet 6 dhe 13, të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Tejzgjatja e kësaj procedure administrative në të tilla afate, e vlerësuar në një këndvështrim më të gjerë, përbën premisa për cënimin e parimit të sigurisë juridike, pasi ky parim presupozon në thelb, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti. Kjo siguri duhet të jepet nga ana e shtetit jo vetëm në pandryshueshmërinë e legjislacionit për marrëdhëniet e rregulluara, por edhe në garantimin e ligjshmërisë së veprimeve që shteti kryen me qytetarët e tij, në marrëdhëniet juridike që ai krijon me ta, duke patur gjithmonë në fokus respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ligjshme, të njeriut.

Ky vlerësim analitik bazohet në parimin kushtetues se, mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të njeriut është jo vetëm një e drejtë e individit por edhe detyrim parësor kushtëzues në veprimtarinë e organeve të administratës shtetërore.

Sipas dispozitave të legjislacionit specifik, në fuqi, dhe më konkretisht të ligjit nr. 20/2020 *“Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”*, tashmë është detyrim i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, që për çdo vetëdeklarim për legalizim ndërtimi informal të paraqitur nga subjektet e ndryshme, të nxjerrë një vendim përfundimtar për përmbylljen e procedurës administrative, të iniciuar pikërisht nga vetëdeklarimi i kryer nga këto subjekte.

Lidhur me këtë çështje risjellim në vëmendjen tuaj, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, si edhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, pasi ndryshe nga legjislacioni që rregullon veprimtarinë e gjykatave shqiptare, (që me shtesat/ndryshimet që iu bënë Kodit të Procedurës Civile në vitin 2017, më konkretisht neni 399/2, u përcaktua qartë “afati i arsyeshëm”, në rastin e legjislacionit administrativ, mungon një përcaktim i tillë konçiz.

Përfitojmë nga rasti të ndalemi në analizimin e asaj se çfarë mund të konsiderohet afat i arsyeshëm. Për analogji do i referohemi trajtimit që i është bërë këtij koncepti nga praktika gjyqësore, si Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (*GjEDNj*) – Vendimi nr. 12, tetor 2021 *“Bara dhe Kola kundër Shqipërisë”*, ashtu edhe nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, (Vendimi nr. 33 datë 01.11.2021).

Në Vendimin nr. 12, tetor 2021 *“Bara dhe Kola kundër Shqipërisë”*, të GjEDNj-së, në pikën 49, paragrafi 4. Zhvillime në lidhje me zgjidhjen përshpejtuese dhe kompensuese: - *Funksionimi dhe efienca e zgjidhjes*, kjo gjykatë shprehet se, citojmë:

“Që prej muajit nëntor 2017, në Shqipëri ka funksionuar një zgjidhje e re përshpejtuese dhe kompensuese për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave gjyqësore. Ajo zbatohet për procedurat në të gjitha gjykatat penale, civile dhe administrative, për hetimet penale dhe procedurat e zbatimit të vendimeve. Ajo nuk zbatohet për procedurat në organet administrative, për të cilat autoritetet janë të mendimit se ka mjaftueshëm garanci legislative”,

Pra, qeveria shqiptare ka dhënë garanci të mjaftueshme legislative që procedurat të përfundojnë brenda një afati të arsyeshëm.

Po në këtë vendim të GjEDNj-së, në paragrafin 94, kjo gjykatë shprehet se, citojmë:

“.... Gjykata përsërit, se pavarësisht reformave të thella në sistemin e drejtësisë dhe vonesën e kuptueshme të shkaktuar prej tyre, Shteti i paditur ka detyrimin e përgjithshëm që të organizojë sistemet e tij ligjore për të garantuar respektim të kushteve parashikuara në nenin 6§1, duke përfshirë edhe kushtin për një proces të rregullt ligjor brenda një afati të arsyeshëm ...”.

Në paragrafin 53, të vendimit nr. 33, datë 01.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, citojmë:

“Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (shih vendimin nr. 18, datë 19.07.2005 të Gjykatës Kushtetuese). Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. (shih vendimet nr. 42, datë 25.05.2017; nr. 22 datë 20.03.2017; nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese)”,

i kushtohet një rëndësi themelore respektimit të të drejtave të njeriut dhe gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Për analogji, në rastin tonë objekt ankimi do të duhej që, ju si organ publik në trajtimin e kësaj çështjeje, të shqyrtonit aplikimin për legalizim brenda afateve ligjore përkatëse.

Ndërkohë që, në paragrafin 70, të vendimit nr. 33, datë 01.11.2021, të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, gjykata shprehet se:

“Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjyimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme, (shih vendimet nr.16, datë 16.03.2021; nr. 76, datë 04.12.2017; nr. 22, datë 20.03.2017; nr. 12, datë 05.03.2012 të Gjykatës Kushtetuese). Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij ose, e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në të kundërt është detyrë e ligjvënësit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht, (shih vendimet nr. 81, datë 28.12.2015; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 46, datë 03.10.2023; nr. 6, datë 16.02.2023; nr. 13, datë 26.05.2022, si dhe nr. 27, datë 11.04.2023, të Gjykatës Kushtetuese)”.

Edhe nëse DVASHK, Sarandë, ndodhet përpara situatës së trajtimit të një numri të lart vetëdeklarimesh, sjellim në vëmendje se, Gjykata Kushtetuese, në paragrafin 71, të po këtij vendimi arsyeton se: *“GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji (shih Buchholz kundër Gjermanisë, 6 maj 1981, § 51). Metodat që mund të nxisin përkohësisht përshpejtimin janë ato kur për gjykimin e çështjeve ndiqet një radhë e caktuar e bazuar jo vetëm në datën e depozitimit të tyre, por edhe në nivelin e urgjencës dhe rëndësisë së tyre dhe në veçanti, të vlerësimit të asaj që përbën rrezik për personat në fjalë. Megjithatë, nëse një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë këto metoda nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive, (shih Guincho kundër Portugalisë, 10 korrik 1984, § 40; Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës, 13 korrik 1983, § 29). Fakti që numri i lartë i çështjeve të tilla të prapambetura është bërë i zakonshëm, nuk e justifikon tejzgjatjen e proceseve gjyqësore, (shih Union Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, 07 korrik 1989, § 40)”.*

Pra, në arsyetimin e sipërcituar, gjykata shprehet qartazi se, ngarkesa e gjykatave (për analogji në rastin tonë ngarkesa e DVASHK-ve, nuk mund dhe nuk duhet të shërbejë si arsye për zgjatjen e shqyrtimit të çështjeve dhe për sa më sipër, në përfundim të analizës së trajtimit të konceptit të afatit të arsyeshëm arrihet në konkluzionin se, vonesa në shqyrtimin e aplikimit për legalizim, datë 08.11.2006, të paraqitur nga z. A. Ll., nuk mund të konsiderohet në përputhje me konceptin e afatit të arsyeshëm.

Në paragrafin 53, të vendimit nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, thuhet se:

“Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjyimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuarit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje

e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve, (shih vendimet nr.16, datë 16.03.2021; nr. 76, datë 04.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese)”.

Është me vend të theksojmë se, mosshqyrtimi administrativ i aplikimeve të shtetasve për legalizim të ndërtimit pa leje, brenda afatit ligjor dhe/ose atij të arsyeshëm, në varësi edhe të rrethanave të tjera të çështjes, mund të përbëjë shkak për nisjen e një procesi për shpërblimin e dëmit, të shkaktuar nga kohëzgjatja e pajustificuar e procedurës administrative. Kjo pasi, fakti që shtetasit për shkaqe të pavarura nga ata, nuk arrijnë të marrin një vendim përfundimtar në një procedurë administrative të iniciuar prej tyre tek organi përkatës kompetent publik, në një kohë që kanë respektuar të gjitha detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, bën që ata të mos arrijnë të gëzojnë nga pronat e tyre, të drejta që ua garanton ky legjislacion.

Është e nevojshme gjithashtu, të sjellim në vëmendjen tuaj edhe përcaktimet e dhëna në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*. Kjo kartë thekson disa të drejta individuale, të rëndësishme, të cilat duhet të respektohen nga ana e organeve publike gjatë kryerjes së shërbimit publik ndaj qytetarëve.

Duke qenë se drejtoria juaj vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, është një organ publik, ofrues i shërbimeve publike, do të duhej që të drejtat e garantuara të qytetarëve që kërkojnë marrjen e shërbimit publik përkatës, nga ana juaj, të mbroheshin dhe respektoheshin korrektësisht prej jush, duke i konsideruar ato si një detyrim ligjor të padiskutueshëm për zhvillimin e procedurave administrative, rast pas rasti.

Ankesa e paraqitur nga z. A. Ll. , konstaton në fakt shkelje të të drejtave, të garantuara nga *“Karta e të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*. Trajtimi i kësaj çështjeje evidenton shkeljen e së drejtës për një zgjidhje efektive, pasi pavarësisht interesimit të vazhdueshëm të ankuesit për zgjidhjen e kësaj problematike, ende sot e kësaj dite, siç edhe rezulton, nuk ka një zgjidhje konkrete.⁴ Jo vetëm kjo, por sikurse na rezulton, ky rast konstaton shkelje të së drejtës së ankuesit për informim,⁵ së drejtës për marrjen e shërbimit brenda afateve të asyeshme dhe marrjes së tij në mënyrë transparente,⁶ si dhe shkelje të së drejtës për shërbim cilësor.⁷

Në gjykimin e Avokatit të Popullit, zvarritja e procesit të vendimmarrjes ndaj vetëdeklarimeve për legalizim të paraqitura nga individët, përbën së pari, mospërbushje të detyrimeve që ju si organ publik keni në marrëdhënien me qytetarët aplikues, dhe së dyti, mospërbushje të detyrimeve që vendi ynë ka në kuadër të proceseve integruese, në Bashkimin Evropian dhe të

⁴ Në pikën 7, të VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*, parashikohet se:

“E drejta për zgjidhje efektive

Ju keni të drejtë të merrni një shërbim përfundimtar për kërkesën e paraqitur. Ne ju garantojmë zgjidhje efektive për shërbimet e kërkuara, duke ju ofruar zgjidhje të shpejtë e të sigurt në favorin tuaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi...Në çdo rast, ne duhet t'ju garantojmë një vendim përfundimtar për çdo kërkesë për përfitimin e shërbimeve publike të paraqitur”.

⁵ Pika 1, e VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*.

⁶ Pikat 9 dhe 10, të VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*.

⁷ Pika 18, e VKM-së nr. 623 datë 26.10.2018, *“Për miratimin e kartës së të drejtave të qytetarit për përfitimin e shërbimeve publike”*.

detyrimeve që atij i lindin si anëtar i organizatave prestigjioze ndërkombëtare, të cilat kanë një aktivitet dhe ndikim të spikatur në fushën e të drejtave të njeriut.

Ajo që kërkohet sot është tejkalimi i gjendjes së “ngërthyer”, nga barazia formale e garantuar me ligj, në garancinë thelbësore të materializuar në veprimtarinë konkrete të organeve shtetërore, të institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe të shoqërisë sonë në tërësinë e saj. Dhe duhet të jemi të bindur se nëse kjo gjë arrihet, kemi hedhur baza të shëndosha të një sistemi efektiv të të drejtave të njeriut.

Nga ana tjetër, në përputhje me pikën 2, të nenit 15, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Mosveprimi evident nga ana juaj në këtë çështje nuk i respekton të drejtat e ligjshme të ankuesit, por përkundrazi është bërë shkak për shkeljen e tyre.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet shprehimisht se:

“Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit...,

- paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrative që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*

REKOMANDOJMË

- 1. Përsheptimin maksimal të procedurave dhe afateve të vendimmarrjes përfundimtare, për shqyrtimin e vetëdeklarimit të paraqitur me aplikimin datë 08.11.2006, nga shtetasi A. Ll. , për legalizimin e ndërtimit informal.*
- 2. Mospërsëritjen e kësaj praktike të kundërligjshme administrative, që rezulton me shkelje të të drejtave të ligjshme, të subjekteve private, për shkak të mosveprimit nga ana e organit publik përgjegjës për përfundimin e kësaj procedure administrative.*

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, kthimi përgjigjes rreth rekomandimit duhet të kryhet brenda 30 ditave nga data e dërgimit të rekomandimit.

Me besim në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj.

KOMISIONERE

Erinda MELI